

**Aneksi A****SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës                         | Struktura e interesuar/<br>Forca                  | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|-------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|     |                                           |                                                   |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1   | “Specialist për planifikimin shëndetësor” | Reparti Ushtarak nr.4001, në Komandën Mbështetjes | Tiranë           | Pa afat                    | Po                                      | Po         | 20.01.2026        | 02.02.2026 |

Formulari nr. 1

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Pozicioni i punës:</b> “Specialist për planifikimin shëndetësor”, në Degën e Shëndetësisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> në Komandën Mbështetëse, Reparti Ushtarak nr.4001.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>4. Vendi:</b> Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 20.01.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 02.02.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <br><b>9. Mënyra e aplikimit:</b><br><br>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:<br><br><i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i><br><br><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i><br><br><i>Tiranë</i> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*).

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **Specialist për planifikimin shëndetësor O/C**
- b. Arsimi : Të ketë diplomë të nivelit “Bachelor”, në Fakultetin e Mjekësisë.
- c. Kualifikimi: Preferohet të ketë kualifikim në fushën e mjekësisë brenda ose jashtë shteti.
- d. Trajnimi: Të ndryshme në fushën e kërkuar.
- e. Eksperienca në Punë: Eksperiencë pune në profesion.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe të jetë i aftë të përdor programeve bazë të kompjuterit, Word, Excel, Power Point,
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.

**Përshkrimi i punës:** Ka për detyrë të Realizon mbështetjen shëndetësore Rol1+ (Medikamente materiale mjekimi dezinfektante) për infermieritë e reparteve vartëse si dhe mbështetjen shëndetësore të të gjitha aktiviteteve që planifikon Komanda Mbështetëse. Planifikon buxhetin financiar për mbështetjen e shërbimit shëndetësor Rol1+.

**Detyrat kryesore:**

- Planifikon, nevojat për buxhetin financiar për vitin pasardhës për mbështetjen e shërbimit shëndetësor Rol1+.
- Njohja me ligjet manualet, direktivën, urdhrat dhe udhëzimet që lidhen me mbështetjen e shërbimit shëndetësor në KM.
- Zbaton aktet ligjore dhe nën/ligjore për ruajtjen, administrimin, qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale të shërbimit shëndetësor në KM.
- Realizon mbështetjen shëndetësore Rol1+ për operacionet, stërvitjet dhe aktivitetet që planifikon Komanda Mbështetëse.
- Kryen kontrolle të vazhdueshme në depot shëndetësore dhe në infermieritë e reparteve vartëse, për gjendjen fizike dhe kushtet e ruajtjes së medikamenteve, materialeve, pajisjeve shëndetësore dhe dokumentacionin përkatës.
- Ndjek procedurën e inventarizimit dhe seleksionimit të materialeve shëndetësore të infermierive të reparteve vartëse të Komandës Mbështetëse.
- Informon shefin e Degës Shëndetësisë për detyrat e ngarkuara sipas afateve si dhe për problemet e konstatuara.

**13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.